

KESHILLI I MINISTRAVE NOMINON FSASH DHE SPASH ANETARE TE KESHILLIT  
KOMBETAR TE PUNES NGA RADHET E ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE

Mbas procedurave ligjore te zhvilluara nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise per percaktimin e organizatave te punedhenesve dhe punemarresve, (sindikatave), me te perfaqesuara ne vend, Keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise, me Vendimin Nr. 1060, date 14. 12. 2013, percaktoi 10 organizatat me te perfaqesuara nga radhet e punedhenesve dhe 10 organizatat me te perfaqesuara nga radhet e punemarresve, (sindikatave).

Sic shihet edhe nga tekstet e VKM Nr.1060, date 14.12.2013 dhe Urdherit Nr. 287, date 18.12.2013, qe po i botojme ne kete numer, **Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, jane nominuar anetare te Keshillit Kombetar te Punes nga radhet e punemarresve, (sindikatave).**

Mbi bazen e ketij vendimi, Ministri i Ceshtjeve Sociale dhe Rinise, z. Erion Veliaj, me Urdherin Nr. 287, date 18.12.2013, emeroi anetaret dhe kandidatet e KKP nga radhet e punedhenesve dhe te punemarresve.

**Sipas propozimeve te bera nga organizatat perkatese, FSASH dhe SPASH perfaqesohen ne kete organ te larte e te rendesishem nga kryetaret e tyre, z. Xhafer Dobrushu dhe z. Nevrus Kaptelli, te cilet jane emruar anetar te Keshillit Kombetar te Punes.**

Me keto vendime u krijuan kushtet per funksionimin e Keshillit te ri Kombetar te Punes me mandat 3 vjecar.

Mbi bazen e ketyre dokumenteve te cituara me siper, me daten 19.12.2013 u zhvillua mbledhja e pare e Keshillit Kombetar te Punes per mandatin e ri. Mbledhja u drejtua nga Ministri i Ceshtjeve Sociale dhe Rinise, z. Erion Veliaj.

Mbas veprimtarive pershendetese, Keshilli degjoi nje informacion te hollesishem nga zv/Ministri i Financave per project-buxhetin e vitit 2014. Ne mbledhje u dhane mendime per ceshtjet qe do te diskutoje dhe konsultoje Keshilli gjate ketij viti.

Perfaqesuesit e FSASH/SPASH, te pranishem ne mbledhje, ngriten disa shqetsime te mesuesve qe lidheshin kryesisht me mosdhenien e shperblimit vjetor, ruajtjen e vendeve te punes, etj.


Ne vijim po botojme tekstet e plota te VKM Nr. 1060, date 14. 12. 2013 dhe Urdherit Nr. 287, date 18. 12. 2013.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M



Nr. 1060, datë 14.12.2013

P Ë R

**CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE  
TË PUNËDHËNËSVE DHE TË PUNËMARRËSVE NË KËSHILLIN  
KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 200, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës janë, si më poshtë vijon:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

- |   |                       |
|---|-----------------------|
| a) Biznesalbania  | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB)                              | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH)                       | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT)                             | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| d) Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pijeve (SHBUP)                     | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| dh) Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (SHSHTI)      | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ë) Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve (DHKPV)                 | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| f) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)                             | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| g) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH)                          | 1 anëtar, 1 kandidat. |

